



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ae.nr.251/2019

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mahir Tutuli, kryetar i kolegjit, Liridon Maloku dhe Qerim Ademaj, anëtarë në çështjen juridike të paditësit [“G...”], me seli në Prishtinë, i përfaqësuar me autorizim nga [XH.K], avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve [“D...”] me seli në Prishtinë, te cilën e përfaqëson me autorizim [N.D] nga Prishtina. për shkak të kompensimit të dëmit në shumën e përgjithshme prej 4,875.00€, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, I.EK.nr.517/2017 të datës 24.05.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 18.11.2020, mori këtë:

AKT GJYKIM

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve [“D...”] me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, I.EK.nr.517/2017 të datës 24.05.2019, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar në piken I të dispozitivit të aktgjykimit e ka miratuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit [“G...”], me seli në Prishtinë, ashtu qe është detyruar i padituri Kompania e Sigurimeve [“D...”] me seli në Prishtinë, që paditësit në emër të shkaktimit të dëmit në automjetin e siguruar kasko t’ia paguaj shumën prej 4,875.00€ me kamatë prej 8% në vit duke e llogaritur nga data 02.06.2016 e deri në pagesën definitive, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi. Ndërsa në piken II të dispozitivit është detyruar i padituri që paditësit t’ia paguaj shumën prej 689.60€ në emër të kompensimit të shpenzimeve të procedurës kontestimore, në afatin prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë e paditura për shkak të vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktik dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke i kërkuar Gjykatës Apelit në Prishtinë ankesën e të paditurit ta aprovoje si të

bazuar dhe aktgjykimin e ankimuar të shkallës së parë ta prishë dhe çështjen t'ia kthej në rigjykim gjykatës së shkallës së parë ose ta ndryshoje aktgjykimin duke e refuzuar kërkesëpadinë e paditësit.

Përgjigje ne ankese nuk ka.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës , aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Paditësi ["G..."], me seli në Prishtinë, me datën 08.11.2017 ka paraqitur padi për kompensimin e dëmit nga sigurimi kasko, kundër të paditurit Kompania e Sigurimeve ["D..."] me seli në Prishtinë. Ka pretenduar se me datën 15.05.2016 në rrugën Prishtinë - Gjilan është shkaktuar aksident i trafikut në të cilin paditësi ka pësuar dëm material. Në momentin e aksidentit me të paditurin ka qenë në raport kontraktues nga kontrata e sigurimit kasko. I ka propozuar gjykatës që të detyrohet e paditura që paditëses t'ia kompensojë dëmin e shkaktuar, kompensimi i dëmit do të behet në atë lartësi që do të ndryshohet vetëm pas marrjes së mendimit nga eksperti i makinerisë dhe të gjitha me kamatë prej 12%, se bashku me shpenzimet e procedurës kontestimore. Paditësi pas nxjerrjes se ekspertizës se makinerisë të punuar nga z. [B.L], me parashtrësën e dorëzuar në seancën e datës 21.05.2019 e ka precizuar kërkesëpadinë në emër të kompensimit të dëmi materiale në shumën e përgjithshme prej 4,875.00€.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave ka gjetur se ishte jo kontestuese se paditësi dhe i padituri kanë qenë në raportin kontraktues nga kontrata për sigurimin kasko. Palët kanë nënshkruar policën e sigurimit kasko me numër ... për automjetin e tipit "Ford Everest XLT 4x4", me [targa të regjistrimit ...], me mbulese siguroese nga data 12.05.2016 e deri me datën 12.05.2017. Ishte jo kontestuese se paditësja si pronar i automjetit ka lidhur marrëveshje për dhënien me qira të automjetit të siguar kasko, me palën e tretë [P.B]. Nga raporti i policisë dhe nga aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni për Kundërvajtje është konstatuar se automjeti i pajisur me policë sigurimi kasko me datën 15.05.2016 është përfshirë në një aksident, ku shkaktar i aksidentit ishte qiramarrësi dhe njëkohësisht vozitësi i automjetit [P.B]. Aksidenti ka ndodhur si rezultat i mospërshtatjes se shpejtësisë se lëvizjes me kushtet në rrugë, me ç 'rast është goditur bankina e betonit e cila ka qenë në atë pjesë të rrugës duke u shkaktuar vet aksident. Dëmi në automjetin e aksidentuar është konstatuar edhe më procesverbalin mbi dëmtimin e automjetit i përpiluar me datën 19.05.2016 nga i paditurit. Ishte jo kontestuese se paditësi i është drejtuar të paditurit për kompensimin e dëmit në automjet në procedure jashtë gjyqësorë, mirëpo i padituri kërkesën e paditësit e ka shqyrtuar dhe ka paraqitur një ofertë për kompensimin në shumën prej 3,393.00€, e cila ofertë nuk është pranuar nga pala paditëse. Kontestuese ndërmjet palëve ishte çështja e lartësisë së kërkesëpadisë. Për të përcaktuar lartësinë

e dëmit material të shkaktuar në automjetin "FORD Everest XLT 4x4", eksperti gjyqësorë i makinerisë z. [B.L] në raportin e ekspertizës ka deklaruar se vlera e dëmit në automjet është në vlerën prej 4,875.00€. Gykata e shkallës së parë e ka vlerësuar raportin e ekspertizës dhe ka ardhur në përfundim se raporti i ekspertizës së makinerisë i punuar nga eksperti [B.L] është në përputhje me provat tjera të lëndës dhe është i arsyetuar në masë të mjaftueshme dhe si të tillë ia ka falur besimin në lidhje me dëmin e përgjithshëm të cilin e ka pësuar automjeti i aksidentuar.

Prandaj, gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në dispozitat e Nenit 918.1, 940, 185 të LMD-së, lidhur me Nenin 452.1 të LPK-së, ka vendosur si në dispozitivit të aktgjykimit.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e Apelit ka gjetur se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale respektivisht Nenet 918, 940 par. 1, kur ka aprovuar tërësisht kërkesëpadinë e paditësit sepse me Nenit 918 të LMD-së përcaktohet se: "*Me kontratën për sigurimin detyrohet kontraktuesi i sigurimit që mbi parimet e reciprocitetit dhe solidaritetit të paguajë një shumë të caktuar shoqërisë së sigurimit (siguruesi), kurse shoqëria detyrohet që, nëse ndodh ngjarja që paraqet rastin e siguruar, t'i paguajë siguruesit apo ndonjë personi të tretë shpërblimin, përkatësisht shumën e kontraktuar ose të kryejë diçka tjetër*". Me Nenin 940 par. 1, përcaktohet se: "*Kur paraqitet rasti i siguruar, siguruesi ka për detyrë të paguajë shpërblimin ose shumën e caktuar me kontratë në afatin e kontraktuar. Kjo gjykatë vlerëson së në rastin konkret i padituri mbanë përgjegjësi për kompensimin e dëmit të paditësit, pasi që aksidenti dhe dëmtimi i automjetit të pajisur me policë sigurimi kasko paraqet rast të siguruar. Ndërsa me Nenin 950.1 paragraf 1 të Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve përcaktohet se "*siguruesi ka për detyrë t'i kompensojë dëmet e lindura rastësisht ose për faj të kontraktuesit të sigurimit, të të siguruarit ose të shfrytëzuesit të sigurimit, përveç në qoftë se për dëmin e caktuar ky detyrim i tij është përjashtuar shprehimisht me kontratën mbi sigurimin.**

Bazuar në dispozitat e sipërcituara, Gjykata e Apelit i vlerësoi si të pabazuara pretendimet ankimore të së paditurës, lidhur me çështjen se me Kushtet e Përgjithshme të Sigurimit neni 4 pika 14 dhe 15 është përjashtuar mbulesa siguroese për automjetet e dhëna me qira, sepse dispozitat të ccilave i referohet pala e paditur nuk e përjashtojnë mbulesën e sigurimit nëse automjeti jepet me qira. Pika 14 përjashton nga mbulesa siguroese vetëm rastet e keqpërdorimit të automjetit nga qiramarrësi, si përvetësimi, mashtrimi apo fshehja të cilat çështje nuk janë objekt shqyrtimi në këtë çështje. Ndërsa pika 15 i përjashton nga mbulesa siguroese vetëm rastet

kur huamarrësi apo qiramarrësi e jep automjetin me nën qira. Në rastin konkret huamarrësi [P.B] nuk e ka dhënë automjetin me nën qira po të njëjtin ka qenë duke e drejtuar personalisht në kohën e aksidentit. Prandaj kjo gjykate vlerëson se i padituri mbanë përgjegjësi për kompensimin e dëmit për palën paditëse , pasi qe aksidenti dhe dëmtimi i automjetit të pajisur me policë sigurimit kasko në rastin konkret paraqet rast të siguruar. Andaj në rastin konkret i padituri mban përgjegjësi për kompensimin e dëmit ndaj paditësit.

Ndërsa nga dispozita e nenit 169 të LMD-së në të cilin është përcaktuar se “*personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendose gjendjen e ekzistuar para se të shkaktohej dëmi. Kur rivendosja nuk është e mundur apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që ta bëjë këtë personi përgjegjës, gjykata do ta caktojë që ai t’ia paguaj dëmtuesit shumën përkatëse në të holla për efekte të kompensimit të dëmit*”. në rastin konkrete vendimi lidhur me lartësinë e dëmit material të pësuar nga paditësi është bazuar në ekspertizën e makinerisë, të punuar nga eksperti gjyqësorë z. [B.L], i cili në raportin e ti ka deklaruar së automjeti i pajisur me policë sigurimi kasko nga i padituri ka pësuar dëm material në shumën prej 4,875.00€.

Gjykata e Apelit i vlerësoi pretendimet ankimore të palës se paditur lidhur me gjendjen faktike, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë përmes ekspertizës profesionale të mjaftueshme, e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse në arsyetimin e aktgjykimit, të cilën e pranon edhe kjo gjykatë, ndërsa pretendimet e paditurës janë në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës të shkallës së parë, në këtë pjesë nuk ka të meta për shkak të se cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, nuk është përfshirë më ndonjë shkelje e cila do të ishte me ndikim për të vendosur ndryshe në këtë çështje juridike, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërshtim me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata e Apelit.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi, në bazë të nenit 195.1 nën pikën d) , të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS,
Ae.nr.251/2019, 18.11.2020

KRYETARI I KOLEGJIT,
Mahir Futuli, d.v

